

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	41 vepra të piktorit të njohur shqiptar Ibrahim Kodra do të prezantohen së bashku në ekspozitën “Deti dh e Muzika”
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/41-vepra-te-piktorit-te-njohur-shqiptar-ibrahim-kodra-do-te-prezantohen--i586637
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:33:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:29:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8a7f0d30fb6387fbf0fa577c1fffb065753383be270262962bc6b5ec55a26ae9
TEKSTI	5d83b5f0a2560f37f71a909c962e8fccc9a290beacef39adc2112dabaf68e7b3
PAMJA	da57d4cdb839c9951f6eec70210542381372137a8b24ec27097d6f9f1673d2cf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	128e973b9e25b5caa56cbb8f2fb3eb4e764348477c3a75e17b098859b46da862
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	554d51ffe1583614fc44621ae1478dd51416957b577076ef62782afd72e64dbf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/128e973b9e25b5caa56cbb8f2fb3eb4e764348477c3a75e17b098859b46da862>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Sekuestrohen dy celulare te paligjshem ne burgje, procedohen 8 persona Nga perdorimi ne pronesi: Kadastra mbylli procesin per 522 Ha toke bujqesore ne Shijak](#)41 vepra fundit

41 vepra të piktorit të njohur shqiptar Ibrahim Kodra do të prezantohen së bashku në ekspozitën “Deti dhe Muzika”



17 Shtator 2026, 11:29Kulturë TEMA



Pas shumë vitesh, 41 vepra të piktorit të njohur shqiptar Ibrahim Kodra do të prezantohen së bashku në ekspozitën “Deti dhe Muzika”, e cila do të hapet më 23 shtator në Bankën e Shqipërisë.

Lajmin e bëri ditur ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, i cili theksoi se veprat, të realizuara përgjatë periudhës 1947–1999, sjellin një rrëfim të ndërtuar përmes ngjyrave, ritmit dhe simbolikës.

Ekspozita synon të sjellë më pranë publikut universin krijues të mjeshtrit shqiptar, përmes një përzgjedhjeje që përfshin jo vetëm pikturat, por edhe fotografi, dokumente dhe objekte personale të artistit.

Ekspozita “Deti dhe Muzika” do të qëndrojë e hapur nga 23 shtatori deri më 23 nëntor 2026, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, me mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Ibrahim Kodra, më i njohuri piktor shqiptar në arenën ndërkombëtare, lindi në Likmetaj të Ishmit, në vitin 1918 dhe u nda nga jeta 20 vjet më parë në Milano. Me një krijimtari të madhe prej gjashtë mijë veprash, ai konsiderohet si një nga modernët më të fuqishëm të piktorëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit të XX. Në historinë e artit modern shqiptar e evropian, Ibrahim Kodra ishte një nga profilet origjinale më të spikatura që edhe pse jetoi jashtë Shqipërisë, ngjyrat dhe tema shqiptare ishin në thelbin e tij artistik.

I vlerësuar si postkubist nga kritikët, në vitin 1996 Kodra mori titullin “Nderi i Kombit” dhe në vitin 1997 u shpall Konsull Nderi dhe iu dha pasaporta diplomatike e Republikës së Shqipërisë. A.K./TemaA



Videoja nuk është e disponueshme

Kjo video mund të mos ekzistojë më ose nuk ke leje për ta shikuar.

Mëso më shumë

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

VIDEO: Nga mitet te dokumentet: koha për ta rilexuar të shkuarën

09:51 Kulturë

Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut/ Kushi: Kujtimi i viktimave është një përgjegjësi morale

09:27 Kulturë

Promovohet novela e Fate Velajt në Pogradec

17:11 Kulturë / 1 koment

Kufiri Shqipëri–Kosovë: nga represioni dhe ndarja, te arkivat, dija dhe bashkëpunimi akademik

16:34 Kulturë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.